



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr.595/6 prot.

Tiranë, më 29.5.2023

VENDIM

Nr. 22, datë 29.5.2023

PËR KONTROLLUESIN “T.N.T EXPRESS ALBANIA SH.P.K.”

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “T.N.T Express Albania sh.p.k.” (në vijim, “Kontrolluesi ose TNT”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 46, datë 15.03.2023 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetim administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi, “T.N.T Express Albania sh.p.k.” (në vijim “TNT”), është shoqëri tregtare, që kryen shërbime postare të llojeve të ndryshme, dërgesa postare, nëpërmjet tokës, detit dhe ajrit, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe jashtë tij. Gjatë ushtrimit të aktivitetit, kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategoritë,

- “klient”, “punonjës”, “vizitor”, etj. Të dhënat personale përpunohen në mënyrë manuale dhe elektronike.*
2. Gjatë hetimit administrativ është konstatuar se Kontrolluesi disponon një sistem elektronik, për menaxhimin e porosive të shoqërisë TNT. Sistemi është i përbërë nga disa module të tilla, si:
- a. Moduli i përdoruesve/agjentëve, i cili popullohet me të dhënat: *“emri i agjencisë, emër dhe mbiemër i punonjësit, email, nr. telefoni, qyteti, historiku, etj.”;*
 - b. moduli i operatorëve;
 - c. moduli i klientëve, i cili popullohet me të dhënat: *“lloji i klientit (individ ose kompani), emër, email, telefon, person kontakti, adresa, etj.”;*
 - d. moduli i porosive, i cili popullohet me të dhënat: *“datë krijimi rekordi, nr. identifikimi të rekordit, numër gjurmueshmërie, statusi i porosisë, kodi i dërguesit, emri, adresa, email, telefon, detaje të porosisë të dërguesit (pako/zarf), etj.”,* si dhe të dhënat e marrësit: *“marrësi/emër, adresa, email, telefon, etj.”;*
 - e. module të tjerë për funksionalitete të ndryshme.

Nga verifikimi në vend, rezulton se të dhënat e *“dërguesve dhe marrësve”* individë (për porositë e realizuara), ruhen nga Kontrolluesi pa përcaktuar një afat konkret të ruajtjes së tyre edhe më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej, në kundërshtim me germën *“d”* të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi ka detyrim të përpunojë të dhënat personale, për aq kohë sa ekziston qëllimi, për të cilin janë grumbulluar dhe përpunuar (neni 5/1/d i Ligjit) dhe në momentin që ka përfunduar qëllimi i përpunimit, të realizojë shkatërrimin e tyre, në të kundërt përpunimi i mëtejshëm i të dhënave konsiderohet i paligjshëm. Koha e ruajtjes së të dhënave personale duhet të përcaktohet nga Kontrolluesi, në përputhje me parashikimet ligjore specifike dhe qëllimin e përpunimit.

3. Kontrolluesi disponon faqen web: <https://tntexpress.al/>, në të cilën ndodhet e publikuar rubrika informuese *“Privatësia”*. Konstatohet se informacioni i pasqyruar në brendësi të kësaj rubrike është i përgjithshëm dhe në tërësi, i referohet *“Rregullave dhe Kushteve”* të përdorimit të shërbimit postar.

Pavarësisht se në përmbajtje parashikohet, ndër të tjera: *“Ruajtja e sekretit të korrespondencës dhe trajtimit konfidencial të çdo informacioni që TNT merr në lidhje me dërguesin, si dhe sigurimin e fshehtësisë të objekteve postare në bazë të ligjit që rregullon mbrojtjen e të dhënave personale”*, konstatohet se përmbajtja e kësaj rubrike nuk përmbush kërkesat e nenit 18 të Ligjit, lidhur me informimin e subjekteve të të dhënave, mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t’i përpunojë të dhënat, afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë, të drejtat që subjektet e të dhënave gëzojnë (akses, korrigjim dhe fshirje), etj.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërmbushja e këtij detyrimi, nga ana e Kontrolluesit, mund të sjellë pasoja të rënda, sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

4. Konstatohet se Kontrolluesi ka marrëdhënie kontraktuale me palët e treta, si në cilësinë e Kontrolluesit po ashtu dhe të Përpunuesit. Konkretisht, Kontrolluesi disponon kontratat e listuara më poshtë.

Kontratë bashkëpunimi me shoqërinë “*Katrori ITS sh.p.k.*”, më datë 01.02.2019, me objekt “*...shërbimet elementare të mirëmbajtjes dhe administrimit të inventarit softwerik dhe përkrahja e shfrytëzuesve në lidhje me to që ofrohen nga ofruesi i shërbimeve në interes të klientit...*”, “*Marrëveshje Bashkëpunimi*” me objekt veprimtarie rregullimin e marrëdhënieve midis “*TNT*” dhe Agjentit. Agjenti mund të jetë person fizik ose juridik, të cilit i jepet e drejta të kryejë për llogari të “*TNT*”, “*Shërbime postare dhe transporti brenda vendit*”. Nga analiza e dispozitave të parashikuara në marrëveshje, si dhe mbështetur në përkufizimin e pikës 5, të nenit 3 të Ligjit, rezulton se “*TNT*” gëzon cilësinë e Kontrolluesit, në këto kontrata/marrëveshje.

Në pikën 11 të marrëveshjes, midis “*TNT*” dhe Agjentit, është parashikuar rubrika “*Mbrojtja e të dhënave personale*”, në përmbajtje të së cilës është parashikuar se: “*Palët bien dakord që kontrata të jetë në përputhje me kërkesat e sanksionuara në ligjin nr. 9887/2008 për mbrojtjen e të dhënave personale...*”.

Në kontratën Shërbim Transporti (mallra) me shoqërinë “*Neptun sh.p.k.*”, datë 16.04.2021, si dhe marrëveshjen e bashkëpunimit me shoqërinë “*NOA sh.a.*”, datë 15.03.2022, “*TNT*” rezulton në cilësinë e ofruesit të shërbimit të shpërndarjes së pakove postare, për klientët e këtyre shoqërive. Mbështetur në përkufizimin e pikës 7, të nenit 3 të ligjit, “*TNT*”, në këto raste gëzon cilësinë e Përpunuesit.

Nga verifikimi i të gjitha kontratave/marrëveshjeve, konstatohet se në përmbajtje të tyre, nuk janë reflektuar detyrimet e parashikuara në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit “*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi*”, i ndryshuar (në vijim, *Udhëzimi nr. 19*).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, të gjitha detyrimet e sanksionuara në nenin 20 të Ligjit duhet të përfshihen në marrëveshjet/kontratat dhe/ose aneks kontratat e nënshkruara mes Kontrolluesit dhe çdo Përpunuesi. Çdo kontratë përpunimi

(*outsourcing/shërbimi*), që ka për qëllim delegimin e përpunimit të të dhënave personale, duhet të përmbajë dispozita që vendosin rregulla për përpunimin e të dhënave personale, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Kontrata të tilla duhet të parashikojnë masat që duhet të marrë Përpunuesi, për të siguruar/garantuar mbrojtjen e mjaftueshme të të dhënave, si dhe hapat që do të ndërmerren në rast cenimi të të dhënave, me qëllim që të sigurojë ligjshmërinë e përpunimit të tyre, në çdo hallkë të këtij përpunimi.

5. Nga verifikimi i kryer në Regjistrin Elektronik të Subjekteve Kontrolluese, si dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit, rezulton se Kontrolluesi ka “*Njoftuar*” mbi përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Gjatë hetimit administrativ të ushtruar, është konstatuar se “*Njoftimi*” ka mangësi në deklarin, sa i përket rubrikave të formularit, si vijon:

- i. Deklarimin në rubrikën 3, të formularit të njoftimit “*kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që përpunohen*”, të tilla si, por pa u kufizuar në to: “*vizitorë*”, “*kandidatë për punë*”;
- ii. Deklarimin në rubrikën 4, të formularit të njoftimit “*kategoritë e të dhënave personale që përpunohen*”, të tilla si, por pa u kufizuar në to: “*numri personal i identifikimit*”, “*numër telefoni*”, “*jeta profesionale*”;
- iii. Deklarimin në rubrikën 6, të formularit të njoftimit “*qëllimi i përpunimit*”;
- iv. Deklarimin në rubrikën 7, të formularit të njoftimit “*marrësit e të dhënave personale*”, të tilla si, por pa u kufizuar në to: “*Agjentët*”.

Konstatimet e mësipërme janë në kundërshtim me parashikimet e neneve 21 dhe 22 të Ligjit. Zyra e Komisionerit vlerëson se, realizimi i detyrimit për ndryshimin e gjendjes së Njoftimit të përpunimit të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 21 të Ligjit, është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen Kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep Ligji.

6. Rezulton se Kontrolluesi disponon “*Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, por konstatohet se në përmbajtje të saj, nuk parashikohen proceset, procedurat, masat teknike dhe organizative ku të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, hartimi i një Rregulloreje specifike “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori të dhënash), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, nivelet e aksesit, etj., konsiderohet një detyrim shumë

i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit, pasi shmang pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

7. Kontrolluesi, gjatë hetimit administrativ, ka vendosur në dispozicion të grupit të kontrollit, Certifikatë Konformiteti “Për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit” ISO 27001:2013 me nr. AQS/SI/66592021, me datë skadence 14.03.2024, lidhur me objektin e aktivitetit. Megjithatë, konstatohet se Kontrolluesi nuk ka mundur të dokumentojë masat organizative dhe teknike të ndërmarra në kuadër të sigurisë së informacionit, gjatë ushtrimit të aktivitetit, veçanërisht nëpërmjet sistemeve elektronike.

Standardi ISO 27001 (i njohur zyrtarisht si ISO/IEC 27001) është një nga standardet më të njohura ndërkombëtare për sigurinë e informacionit. Certifikimi ISO 27001 është i përshtatshëm për çdo organizatë, të madhe apo të vogël, në çdo sektor. Standardi është veçanërisht i rëndësishëm kur mbrojtja e informacionit është kritike si dhe është gjerësisht i zbatueshëm për organizatat që menaxhojnë sasi të mëdha të të dhënave ose informacion në emër të organizatave të tjera.

Zyra e Komisionerit vlerëson dhe inkurajon certifikimin e çdo Kontrolluesi, që përpunon sasi të konsiderueshme të dhënash me Certifikatën e Konformitetit ISO 27001 (apo ekuivalente me të), pasi zotërimi i një Sistemi të Menaxhimit të Sigurisë së Informacioneve, i cili është zbatuar në mënyrë të saktë, është një mjet me anë të të cilit Kontrolluesit/Përpunuesit, reduktojnë rreziqet që mund të pësojnë asetet e informacionit.

Mirëpo, pajisja me këtë Certifikatë Konformiteti, duhet të ndjekë një procedurë të rregullt, që të përfshijë të gjitha kontrollet ligjore, fizike dhe teknike në proceset e menaxhimit të riskut të një organizate, dhe mbi të gjitha duhet të realizohet nga një organizëm i akredituar për certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit.

Disponimi i këtyre certifikatave, thjesht dhe vetëm formalisht nga Kontrolluesit, pa dokumentuar masa konkrete për sigurinë e informacionit, cenon besimin mbi standardet e sigurisë së informacionit të ndërmarra efektivisht, për proceset e punës që kryen Kontrolluesi, ku përfshihet edhe përpunimi i të dhënave personale.

Për më tepër, nga verifikimi në faqen e organit certifikues AQS Cert, konstatohet se Certifikata e Konformitetit ISO 27001:2013, që disponon Kontrolluesi rezulton se aktualisht është e pezulluar. Pavarësisht këtij fakti, gjatë hetimit administrativ, Kontrolluesi nuk ka mundur të dokumentojë/demonstrojë përputhshmërinë e veprimtarisë, me këtë standard certifikimi.

Nga ana tjetër, sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale, është konstatuar se mungojnë elementë të sigurisë së të dhënave si, “Dokumentimi i proceseve të

politikave të miratuara nga Kontrolluesi”, “Analizë e ndikimit në të dhëna personale” për proceset përpunuese, “Sigurinë e personelit dhe pajisjeve elektronike të lëvizshme ose jo”, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit datë 14.09.2018 “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha” (në vijim, “Udhëzimi nr. 47”).

Zyra e Komisionerit konstaton mosplotësim të detyrimeve në lidhje me ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit të Menaxhimit së Sigurisë së Informacionit (SMSI), lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, të parashikuara në Udhëzimin nr. 47 të Komisionerit.

Sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se Kontrolluesi nuk ka marrë masa organizative dhe teknike të përshtatshme, për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme apo humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht në rastet kur përpunimi i të dhënave kryhet nëpërmjet instrumenteve elektronike, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Kontrolluesi, është i detyruar të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

Konstatohet, gjithashtu, se Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Sipas përcaktimeve të Kreut IV, të Udhëzimit nr. 47, trajnimet në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale duhet të jenë të vazhdueshme dhe të përshtatura, sipas nevojave dhe proceseve të punës së Kontrolluesit, me qëllim ndërgjegjësimin e operatorëve, të cilët për shkak të proceseve të punës, janë të ngarkuar për përpunimin e të dhënave personale. Gjithashtu, konstatohet se masat e ndërmarra nga Kontrolluesi, janë të pamjaftueshme në raport me veprimtarinë e gjerë që kryen.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit në rrugë postare.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesja e Kontrolluesit u paraqit në seancën dëgjimore, ku parashtrori qëndrimin e saj me shkrim, mbi konstatimet e grupit të hetimit.

Me shkresën nr. 595/4 prot., datë 03.05.2023, Kontrolluesi parashtrori argumentet e përmbledhura, si më poshtë:

Lidhur me pikën 2 të procesverbalit, kontrolluesi pretendon se, *“Referuar pikës “d” të ligjit, nuk shohim të përcaktuar një afat ruajtjeje për këto lloj të dhënash “dërgues dhe marrës”, por diktohet se mbajtja e të dhënave në atë formë që të lejoj identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë por jo më tepër se sa është e nevojshme për qëllimin. Nga ana jonë këto të dhëna mbahen për evidencë në rast të pretendimeve nga klientët ose në rastet kur klientët ende nuk kanë shlyer detyrimet me kompaninë për shërbimin e ofruar. Ruajtja e tyre bëhet konform ligjit të arkivimit të dokumenteve.”*

Lidhur më këtë pretendim, Zyra e Komisionerit vlerëson se Kontrolluesi nuk e ka ende të qartë detyrimin e parashikuar në germën “d” të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit. Konkretisht, ligji, në nenin 5 të tij, parashikon parimet për përpunimin e drejtë të të dhënave, ndër të cilat, gjendet edhe parashikimi për ruajtjen e tyre brenda një afati konkret, por jo më tepër se sa është e nevojshme për qëllimin për të cilat janë grumbulluar. Ky parim duhet të zbatohet nga çdo Kontrollues dhe për rrjedhojë, ligji nuk mund të parashikojë një afat që të jetë efektiv për të gjithë Kontrolluesit, pasi afati ndikohet nga lloji i aktivitetit (*fusha e veprimtarisë*), që ushtrohet nga Kontrolluesi, si dhe qëllimi i përpunimit të të dhënave.

Përcaktimi i afateve kohore për ruajtjen e të dhënave, duhet të jetë i parashikuar konkretisht në akte të brendshme rregullatore/politika, etj. Konkretisht, Kontrolluesi duhet të identifikojë rast pas rasti, kategoritë e të dhënave që përpunon, si dhe duhet të përcaktojë afatet e ruajtjes së këtyre të dhënave, në përputhje me qëllimin e grumbullimit, në mënyrë që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për këtë qëllim.

Lidhur me pikën 3 të procesverbalit, Kontrolluesi pretendon se në optikën e vet, i është përmbajtur kërkesave dhe rregullave të diktuar në nenin 18 të ligjit, pasi në faqen web: <https://tntexpress.al/>, në rubrikën informuese “Privatësia”, specifikohet: *“TNT është i detyruar të ruajë sekretin e korrespondencës, si dhe të kujdeset për trajtimin konfidencial të çdo informacioni që merr në lidhje me veprimtarinë e dërguesit. TNT ofron shërbim postar, çka nënkupton që të dhënat e mbledhura do të përdoren vetëm për këtë shërbim. Klientët janë në dijeni të qëllimit të përdorimit të të dhënave, konkretisht “dërgimi i porosisë”. Referuar ligjit nuk specifikohet një mënyrë konkrete se si mund të bëhet njoftimi i klientit.”*

Lidhur më këtë pretendim, Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi nuk i ka të qarta detyrimet e parashikuara në nenin 18 të Ligjit. Konkretisht, sipas kësaj dispozite, Kontrolluesi duhet të informojë të gjithë subjektet e të dhënave që aksesojnë në faqen e

tij zyrtare, mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t'i përpunojë të dhënat, afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë, të drejtat që subjektet e të dhënave gëzojnë lidhur me aksesin, korrigjimin dhe fshirjen e tyre, etj. Nga hetimi administrativ i kryer, është konstatuar se informacioni i pasqyruar në brendësi të kësaj rubrike, është i përgjithshëm, dhe në tërësi i referohet “Rregullave dhe Kushteve” të përdorimit të shërbimit postar dhe nuk përmbush informimin e subjekteve të të dhënave, sipas kërkesave të nenit 18 të Ligjit.

Për t'i ardhur në ndihmë çdo Kontrolluesi, Zyra e Komisionerit ka publikuar gjithashtu, një material “Opinion mbi mbrojtjen e të dhënave personale në faqet e internetit të kontrolluesve publikë dhe privatë”, ku sqarohet, në mënyrë të detajuar, rëndësia e hartimit dhe publikimit të “Politikave të Privatësisë” në faqen e internetit për çdo kontrollues publik, po ashtu edhe për ato privatë, me qëllim përmbushjen e detyrimit të nenit 18 të Ligjit.

Lidhur me konstatimin sa i përket “Verifikimit të kontratave/marrëveshjeve”, Kontrolluesi pretendon se “në të gjitha kontratat/marrëveshjet e nënshkruara janë përcaktuar qartë kërkesat e nenit 20 të ligjit dhe Udhëzimit nr.19 në lidhje me konfidencialitetin e informacionit që trajtohet apo të dhënat që përdoren nga të dyja palët.”

Zyra e Komisionerit vlerëson se ky pretendim nuk qëndron, pasi pavarësisht faktit që në disa nga kontratat/marrëveshjet e mësipërme janë parashikuar dispozita ku përmendet ligji për mbrojtjen e të dhënave personale, konstatohet se në përmbajtje të tyre nuk janë reflektuar detyrimet e parashikuara në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit. Të gjitha detyrimet e sanksionuara në nenin 20 të Ligjit, duhet të përfshihen në marrëveshjet/kontratat dhe/ose aneks kontratat e nënshkruara mes Kontrolluesit dhe çdo Përpunuesi.

Me qëllim ardhjen në ndihmë kundrejt çdo Kontrolluesi, Zyra e Komisionerit, në Aneksin 1, të Udhëzimit nr. 19, ka publikuar gjithashtu një “Kontratë-tip për përpunimin e të dhënave personale nga një kompani e tretë”, të cilës Kontrolluesi mund t'i referohet.

Lidhur me pikën 5 të procesverbalit, Kontrolluesi pretendon se: “..Në pikën (ii), në formularin e njoftimit në Rubrikën 4 janë përmendur vetëm të dhënat të cilat përpunohen nga ana jonë. Në pikën (iii), në këndvështrimin tonë, mendojmë që i kemi përmbushur kërkesat e ligjit në lidhje me qëllimin e përdorimit të të dhënave, përfshi dhe subjektet marrëse të këtyre të dhënave.”

Zyra e Komisionerit vlerëson se, pretendimet e mësipërme të Kontrolluesit nuk qëndrojnë për arsye se, nga verifikimi i përmbajtjes së Formularit të Njoftimit të administruar në cilësinë e provës materiale, sikurse referuar edhe konstatimeve në vend, rezulton se “ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit”, nevojitet të kryhet në disa rubrika (siç janë reflektuar konkretisht në pikën 5, më sipër).

Lidhur me pikën 6 të procesverbalit ku konstatohet se: “Ka mangësi te rregullorja e kompanisë "Për përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave", Kontrolluesi pretendon se: “Janë marrë këto masa duke u përfshirë në rregullore: -Kreu “V” përmban informacionin në lidhje me masat administrative në rast moszbatimi të kësaj rregulloreje. Në qoftë se veprimet e tyre nuk përbëjnë vepër penale ndaj tyre merren masa administrative dhe disiplinore sipas akteve normative në fuqi.- Punonjësit informohen në lidhje me procedurat dhe Rregulloren për mbrojtjen e të dhënave personale, që në momentin e fillimit të marrëdhënies së punës. -Disponohet një server room që menaxhohet vetëm nga përgjegjësi i IT-së. Secili punonjës ka akses shumë të mirë përcaktuar dhe askush nuk ka të drejtë për të ndryshuar apo përdorur të dhëna. Marrja e informacioneve bëhet vetëm në rastet me urdhër nga institucionet shtetërore, me konfirmim nga Administratori i shoqërisë. TNT ka të huazuar tek Megatek ruajtje dhe administrimin e të gjitha të dhënave (server, website etj.)”.

Lidhur më këtë pretendim të Kontrolluesit, Zyra e Komisionerit vlerëson angazhimin për të rikuperuar këtë shkelje pas konstatimit në procesverbal, megjithatë, mangësitë e përmendura sa i përket masave teknike dhe organizative, provojnë qartësisht se masat e parashikuara nga Kontrolluesi janë fiktive, të paqarta, të padokumentuara dhe të pamjaftueshme, në raport me parashikimet e nenit 27 të Ligjit.

Në përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuptim të germave “a”, “b”, “ç”, “d” dhe “dh” të pikës 1, të nenit 39 të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

- a) kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II “Përpunimi i të dhënave personale”, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;
- b) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;
- ç) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;
- d) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;
- dh) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë;

Në bazë të pikës 2, të nenit 39 të Ligjit, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara dhe pasojat janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave, me informimin dhe garantimin e të drejtave të

subjekteve të të dhënave, si dhe marrjen e masave të përshtatshme teknike dhe organizative për sigurinë e të dhënave personale.

PËR KËTO ARSYE:

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 18, 20, 21, 22, 27, 29, 30, 39 pika 1, gjerat “a”, “b”, “ç”, “d” dhe “dh”, si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit,

V E N D O S A:

- 1- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në Kreun II të Ligjit;
- 2- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 18 të Ligjit;
- 3- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 20 të Ligjit;
- 4- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 21 të Ligjit;
- 5- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenet 27 dhe 28 të Ligjit;
- 6- Kontrolluesi, të ketë në vëmendje përpunimin e të dhënave personale, për të gjitha proceset përpunuese, në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të sanksionuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit,
- 7- Kontrolluesi, të marrë masa për përcaktimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave, për të gjitha proceset e përpunimit, në përputhje me gjerën “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit;
- 8- Kontrolluesi, të marrë masa konkrete, për përmbushjen e detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale, në zbatim të detyrimeve të nenit 18 të Ligjit;
- 9- Kontrolluesi, të marrë masa për të rishikuar marrëveshjet e bashkëpunimit me përpunuesit, duke specifikuar detyrimet midis palëve, si dhe të monitorojë, në vijimësi, zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në marrëveshjet me përpunuesit, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit;

- 10-** Kontrolluesi, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit, të ketë në vëmendje përditësimin e “Njoftimit”, në lidhje me ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave personale, të cilat përpunon;
- 11-** Kontrolluesi, në zbatim të neneve 27 dhe 28 të Ligjit, të marrë masa për hartimin e rregullores “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, duke parashikuar masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, garantimin e konfidencialitetit etj., në funksion të aktivitetit të tij, për çdo proces përpunimi;
- 12-** Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, si dhe krijimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale;
- 13-** Në zbatim të pikës 1, të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti, brenda afateve, si vijon:
- i. vazhdimisht, detyrimet e përcaktuara në pikat 6 dhe 8 më sipër;
 - ii. brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimin e përcaktuar në pikën 7 më sipër;
 - iii. brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimin e treguar në pikat 9 dhe 10 më sipër;
 - iv. brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve, detyrimet e treguara në pikat 11 dhe 12 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes në dijeni të këtij akti;

- 14-** Kontrolluesi të njoftojë Zyrën e Komisionerit për masat e marra;
- 15-** Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbartimit;
- 16-** Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më datë 29.5.2023.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi